

# RELACION

## I PROJEKTLIGJIT

### “PËR BURIMET UJORE”

#### I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj është hartuar si pjesë e paketës ligjore në kuadër të përafrimit të plotë të legjislacionit Shqiptar në fushën e menaxhimit të burimeve ujore me acquis të Bashkimit Evropian në këtë fushë nëpërmjet mbështetjes së projektit “Mbështetja e Bashkimit Evropian për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri”, financuar nga BE dhe ADA. Një nga komponentët e këtij projekti është “Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”.

Procesi i përafrimit ka kaluar në dy faza. Në fazën e parë është bërë identifikimi i legjislacionit të BE-së në fushën e ujit, analizimi i legjislacionit shqiptar, krahasimi i dy legjislacioneve, identifikimi i mangësive në legjislacionin shqiptar dhe hartimi i raportit me rekomandimet përkatëse. Në fazën e dytë është bërë hartimi i planit për përfshirjen e direktivave në legjislacionin vendas, krijimi i strukturës së normave ligjore, hartimi i normave të reja ligjore dhe hartimi i akteve nënligjore përkatëse.

Si rezultat i dy fazave u bë hartimi i neneve, numri i të cilave dhe ndryshimet që ato sjellin në ligjin nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, e tejkalonin masën e nevojshme për të bërë ndryshime në ligjin aktual, në këto kushte, lindi nevoja e hartimit të ligjit të ri për menaxhimin e ujit në Shqipëri. Në kuadër të finalizimit të paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore, është ngritur Grupi Ndërinstitucional i Punës në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit Nr.24 datë 9.02.2021, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore” i cili filloi punën në prill të vitit 2021 e vijoi edhe gjatë vitit 2022.

Ky projektligj ka si qëllim të përcaktojë kuadrin ligjor dhe institucional për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore me synim mbrojtjen e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë duke siguruar ruajtjen,

zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të tyre, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social ekonomik të vendit.

Projektligji synon të arrijë këto objektiva:

- (a) mbrojtjen, përmirësimin dhe parandalimin e përkeqësimit të mëtejshëm të statusit të ekosistemeve ujore lidhur me nevojat e tyre për ujë, ekosistemeve tokësore dhe ligatinave që janë në varësi të drejtpërdrejtë nga këto ekosisteme;
- (b) promovimin e përdorimit të qëndrueshëm të ujit bazuar në mbrojtjen afatgjatë të burimeve ujore të disponueshme;
- (c) përforcimin e mbrojtjes dhe përmirësimin e mjedisit ujor, ndër të tjera, përmes zbatimit të masave të veçanta për:
  - (i) uljen progresive të shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve të substancave prioritare, ndërprerjen ose uljen graduale të shkarkimeve, emetimeve dhe humbjeve të substancave prioritare të rrezikshme nga burimet dhe veprimtaritë industriale;
  - (ii) kontrollin e ndotjes nga burimet e ujërave të ndotura urbane;
  - (iii) kontrollin e ndotjes nga nitratet nga burimet me origjinë bujqësore;
- (ç) uljen progresive të ndotjes së ujërave nëntokësore dhe parandalimin e ndotjes së mëtejshme të tyre;
- (d) zbutjen e efekteve të përmytjeve dhe thatësirave duke kontribuar në:
  - (i) sigurimin e furnizimit të mjaftueshëm me ujëra sipërfaqësore dhe ujëra nëntokësore të cilësisë së mirë, sipas nevojave për përdorimin e qëndrueshëm, të ekuilibruar dhe të drejtë të ujit;
  - (ii) uljen e ndjeshme të ndotjes së ujërave nëntokësore;
  - (iii) mbrojtjen e ujërave territoriale dhe detare;
  - (iv) përmbushjen e objektivave të marrëveshjeve përkatëse ndërkombëtare, përfshi ato që synojnë parandalimin dhe eliminimin e ndotjes së mjedisit detar, përmes veprimeve për të ndaluar ose pakësuar gradualisht deri në zero shkarkimet, emetimet dhe humbjet e substancave prioritare, duke pasur si qëllim përfundimtar arritjen e përqendrimeve në mjedisin detar afër vlerave bazë për substancat natyrore dhe afër zeros për substancat sintetike të krijuara nga njeriu; dhe
- (e) përcaktimin e koordinimit të plotë të të gjitha veprimtarive ndërmjet autoriteteve kompetente lidhur me dhënien e autorizimeve mjedisore,

lejeve, dhe koncesioneve për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e trupave ujorë.

## **II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE.**

Fusha e Menaxhimit të Ujërave është një nga fushat prioritare në kuadër të procesit të integritit, detyrimet e së cilës përcaktohen në nenin 70/3 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, i cili parashikon domosdoshmërinë e përafrimit të legjislacionit vendas me “*acquis communautaire*”. Ndërkohë që, neni 108 i MSA-së vë theksin në zhvillimin dhe bashkëpunimin e palëve me qëllim që të promovojnë qëndrueshmërinë mjedisore.

Projektligji është parashikuar në PKIE 2022-2024, Kapitulli 27, “Mjedisi”, fusha “Cilësia e ujit”.

Projektligji është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2022 (sipas Vendimit nr.850, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, planifikuar për katërmujorin e tretë të vitit.

Menaxhimi i integruar i ujit është një ndër prioritetet e qeverisë shqiptare. Ky prioritet theksohet në Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (miratuar me VKM nr. 348 datë 11.5.2016).

Gjithashtu ky projektligj është në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore 2018-2027, ku përcakton në pikën 2.4.3 “Problematikat kryesore lidhur me menaxhimin e ujit” se objektivi për arritjen e detyrimeve që vijnë nga Bashkimi Evropian në sektorin e ujit është fillimisht nëpërmjet hartimit të një legjislacioni.

## **III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME.**

Situata ekzistuese në sektorin e ujit në përgjithësi dhe për kuadrin ligjor që rregullon menaxhimin e integruar të burimeve ujore, paraqitet relativisht e

cunguar, si një kornizë e gjerë, komplekse, me ndërthurje të shumë aktorëve, si dhe e fragmentuar në shumë ligje dhe akte nënligjore.

Sektori i ujit luan një rol të rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të vendit. Ai lidhet ngushtë me prodhimin e energjisë elektrike, zhvillimin e bujqësisë, turizimin dhe rekreacionin. Në procesin e integritit evropian arritja e standardeve të BE-së në sektorin e ujit konsiderohet si një nga proceset më të vështira dhe të kushtueshme.

Me anë të ligjit nr.111/2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” është përafuar plotësisht vetëm Direktiva 2000/60/EC “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të Evropës e datës 23 Tetor 2000, ndërsa projektligji i propozuar së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij synon të përafrojë plotësisht direktivat e BE-së në fushën e ujit.

Me qëllim plotësimin e kuadrit ligjor përkatës dhe duke konsideruar rëndësinë e përafritit të plotë të legjislacionit në fushën e menaxhimit të burimeve ujore me atë të Bashkimit Evropian propozohet miratimi i këtij projektligji.

Projektakti synon rregullimin e të gjitha çështjeve që lidhen me menaxhimin e burimeve ujore, si përcaktimin e organeve përgjegjëse, standardet e cilësisë mjedisore lidhur me ujërat, çështjet që lidhen me monitorimin e ujërave, si dhe rregullimin e çështjeve të lidhura me përdorimin e burimeve ujore me leje apo autorizim.

Ky projektligj synon:

- Përcaktimin e kuadrit ligjor dhe institucional për administrimin dhe menaxhimin e burimeve ujore me synim mbrojtjen e burimeve ujore të Republikës së Shqipërisë duke siguruar ruajtjen, zhvillimin dhe shfrytëzimin sa më racional të tyre, të domosdoshme për jetën dhe për zhvillimin social ekonomik të vendit;
- Mbrojtjen e ujërave sipërfaqësorë duke përcaktuar objektivat e cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësorë;
- Mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe përkeqësimi duke përcaktuar objektivat e cilësisë mjedisore për ujërat nëntokësorë;
- Krijimin e Regjistrit të Zonave të Mbrojtura që përfshijnë masa të veçanta ruajtjeje me qëllim mbrojtjen e ujit dhe ekosistemeve ujore;
- Përcaktimin e rregullave për monitorimin e ujërave sipërfaqësorë, nëntokësorë dhe zonave të mbrojtura;

- Përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara për zbatimin e këtij ligji, veçanërisht sa i përket hartimit, rishikimit dhe përditësimit të planeve të menaxhimit të burimeve ujore;
- Kontrollin e ndotjes;
- Përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore me qëllim arritjen e statusit të mirë kimik në të gjithë trupat ujorë sipërfaqësorë;
- Vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga përmbytjet dhe mbrojtjen nga përmbytjet;
- Përcaktimin e rregullave për përdorimin e burimeve ujore dhe përgjegjësi të institucioneve lidhur me lëshimin e lejeve dhe autorizimeve përkatëse.

#### **IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR.**

Ky projektligj hartohet në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

Projektvendimi është në përputhje me Direktivën 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, të datës 23 tetor 2000, “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e Komunitetit në fushën e politikës së ujërave” (Nr.CELEX 32000L0060), Direktivën 2007/60/CE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 23 tetor 2007, “Për vlerësimin dhe menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve” (Nr. CELEX 32007L0060), Direktivën 2008/105/EC “Për vendosjen e standardeve mjedisore të ujërave sipërfaqësorë, amenduar me Direktivën 2013/39/EU, Direktivën 2006/118/EC Për “Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore ndaj Ndotjes dhe Përkeqësimit”, Direktivën 2010/75/EU Për “Mbrojtjen dhe monitorimin e ndotjes së ujërave nga aktivitetet industriale, Direktivën 91/676/EEC Për “Mbrojtjen e Ujërave nga Ndotjet e Nitrateve të Përdorura në Bujqësi”, Direktivën 2009/90/EC për “Përcaktimin e Specifikimeve Teknike për Analizat Kimike dhe Monitorimin e Statusit të Ujërave”, Direktivën 91/271/EEC Për “Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane”.

## **V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE).**

Projektligji synon që nëpërmjet tij dhe akteve nënligjore në zbatim të tij të bëhet transpozimi i plotë i disa direktivave të BE-së si:

- Direktiva 2000/60/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 23 Tetor 2000 “Ngritja e një kuadri ligjor për veprimet e komunitetit në fushën e politikës së ujërave”, amenduar me Vendimin 2455/2001/EC, Direktivën 2008/32/EC dhe Direktivën 2008/105/EC;
- Direktiva 2008/105/EC për vendosjen e standardeve mjedisore të ujërave sipërfaqësorë, amenduar me Direktivën 2013/39/EU;
- Direktiva 2006/118/EC Për “Mbrojtjen e Ujërave Nëntokësore ndaj Ndotjes dhe Përkeqësimit”;
- Direktiva 2010/75/EU Për “Mbrojtjen dhe monitorimin e ndotjes së ujërave nga aktivitetet industriale;
- Direktiva 91/676/EEC Për “Mbrojtjen e Ujërave nga Ndotjet e Nitrateve të Përdorura në Bujqësi”;
- Direktiva 2007/60/EC Për “Vlerësimin dhe Menaxhimin e Rreziqeve nga Përmbytjet”;
- Direktiva 91/271/EEC Për “Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane”;
- Direktiva 2009/90/EC për “Përcaktimin e Specifikimeve Teknike për Analizat Kimike dhe Monitorimin e Statusit të Ujërave”.

## **VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT.**

Projektligji përmban 180 nene gjithsej, të përfshirë në tetëmbëdhjetë krerë.

**Kreu I** trajton dispozitat e përgjithshme që i referohen qëllimit, objektit të ligjit dhe përkufizimeve të termave. Në këtë kre përcaktohet pronësia e burimeve ujore duke parashikuar se janë në pronësi publike dhe administrim të organeve shtetërore të gjitha burimet ujore të Republikës së Shqipërisë dhe e drejta e pronësisë publike është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme.

Gjithashtu parashikohen parimet e menaxhimit të integruar të burimeve ujore.

**Kreu II** trajton organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore dhe kompetencat e tyre ku pjesë e tij është seksioni II.2 për përcaktimin ndarjes së territorit të Republikës së Shqipërisë për efekt të menaxhimit të burimeve ujore, baseneve dhe nënbaseneve ujore si dhe rajonet e baseneve lumore dhe autoritetet kompetente brenda secilit rajon të basenit lumor. Seksioni II.3 përmban dokumentet e planifikimit të menaxhimit të burimeve ujore dhe zbatimin e tyre (politikat, strategjia, planet e menaxhimit). Ky seksion, trajton gjithashtu, bashkëpunimin ndërkufitar dhe zbatimin e marrëveshjeve ndërombëtare dhe përcakton organin që ngarkohet me menaxhimin e ujërave ndërkufitare dhe administrimin e marrëdhënieve me shtetet kufitare për këto ujëra, sipas legjislacionit shqiptar dhe marrëveshjeve të tjera përkatëse ndërkombëtare.

**Kreu III** përcakton objektivat e cilësisë mjedisore dhe përmban dispozita lidhur me objektivat e cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore, përputhshmërinë me objektivat e cilësisë mjedisore për zonat e mbrojtura. Ky kre, parashikon gjithashtu, objektivat më pak shtrënguese të cilësisë mjedisore dhe kushtet që duhet të përmbushen për shtyrjen e afateve kohore për arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore për ujërat sipërfaqësore.

**Kreu IV** parashikon analizat dhe vlerësimet e rajoneve të baseneve lumore ku përfshihen analizimi i karakteristikave të baseneve ujore dhe vlerësimi i ndikimit të aktivitetit njerëzor në statusin e ujërave sipërfaqësore, analizat ekonomike të përdorimit të ujit për çdo basen lumor ose liqenor, rikuperimi i kostos së përdorimit të burimeve ujore si dhe raportimin për zbatimin e tyre.

**Kreu V** parashikon Regjistrin e Zonave të Mbrojtura duke përcaktuar zonat që përfshihen te zonat e mbrojtura, autoritetet përgjegjëse për identifikimin dhe shpalljen e tyre dhe rastet e pashmangshme për shpalljen e zonave të mbrojtura. Dispozitat e këtij kreu përmbajnë rregulla për përcaktimin, përbërjen dhe autoritetet përgjegjëse për përcaktimin dhe miratimin e kufijve të zonave të mbrojtjes higjieno-sanitare. Dispozita të tjera të këtij kreu trajtojnë zonat për mbrojtjen e llojeve të peshkut dhe organizmave të tjerë ujorë me rëndësi ekonomike, zona të veçanta ruajtjeje, zonat e rrezikshme për shëndetin e njeriut. Në këtë kre përcaktohet detyrimi i bashkërendimit të planeve të rregullimit të territorit dhe planeve të

menaxhimit të baseneve lumore. Ky kre, ngarkon gjithashtu, organet përgjegjëse për identifikimin e trupave ujorë që përdoren për ujë të pijshëm dhe mbrojtjen e trupave ujorë të identifikuar, si dhe organet përgjegjëse për hartimin e kriterëve dhe standardeve për cilësinë e ujit të pijshëm.

**Kreu VI** trajton monitorimin e ujërave sipërfaqësorë dhe nëntokësorë, zonave të mbrojtura duke parashikuar rregulla për hartimin dhe zbatimin e programit të monitorimit. Dispozitat e këtij kreu përmbajnë rregulla lidhur me specifikimet teknike për analizën kimike dhe monitorimin.

**Kreu VII** parashikon masat që duhen marrë për arritjen e objektivave të cilësisë mjedisore. Dispozitat e këtij kreu përcaktojnë që autoritetet përgjegjëse për të gjitha shkarkimet dhe emetimet në ujërat sipërfaqësorë të përmendura të zbatojnë qasje të kombinuar për kontrollin e tyre. Ky kre ngarkon organin përgjegjës për hartimin e një programi masash, të cilat janë themelore ose plotësuese, bazuar në rezultatet e analizave të përcaktuara në këtë ligj duke përcaktuar afatet për vënien në zbatim të programeve të masave. Në këtë kre parashikohet edhe rasti i identifikimit të një problematike, e cila ndikon në menaxhimin e burimeve ujore dhe dhënia e rekomandimeve për zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu dispozitat e këtij kreu trajtojnë edhe planet e menaxhimit të baseneve lumore duke parashikuar rregullat përsa i përket elementeve që duhet të përfshihen, miratimit dhe publikimit.

**Kreu VIII** parashikon rregulla përsa i përket informimit publik duke ngarkuar organin përgjegjës për të garantuar përfshirjen aktive të të gjitha palëve të interesuara veçanërisht përsa i përket hartimit, rishikimit dhe përditësimit të planeve të menaxhimit të baseneve lumore. Ky kre, parashikon gjithashtu, raportimin dhe publikimin lidhur me planet e menaxhimit të baseneve lumore.

**Kreu IX** parashikon rregulla për mbrojtjen e ujërave nëntokësorë nga ndotja dhe përkeqësimi. Në këtë kre përcaktohen objektivat e cilësisë mjedisore për ujërat nëntokësorë si dhe trajtohen karakteristikat e rajoneve të baseneve lumore dhe vlerësimi i ndikimit të veprimtarisë njerëzore në ujërat nëntokësorë. Dispozitat e këtij kreu përmbajnë rregulla për vlerësimin e statusit kimik të ujërave nëntokësorë dhe ndalimin e depërtimit të ndotësve në ujërat nëntokësorë, ngarkohen organet përgjegjëse për monitorimin e



ujërave nëntokësorë për vlerësimin e statusit sasior dhe kimik dhe për përcaktimin e standardeve të cilësisë për ujërat nëntokësorë.

**Kreu X** parashikon rregulla për kontrollin e ndotjes së ujërave, ku pjesë e tij është seksioni 1, për përcaktimin e standardeve të cilësisë mjedisore të ujërave sipërfaqësorë, seksioni 2, për kontrollin e shkarkimeve të ujërave industriale, seksionin 3, për kontrollin e shkarkimit të ujërave të ndotura urbane, seksionin 4 për kontrollin e ndotjes nga burime të ndryshme.

**Kreu XI** parashikon rregulla për menaxhimin e rrezikut nga përmbytjet dhe mbrojtjen nga përmbytjet. Dispozitat e këtij kreu trajtojnë vlerësimin paraprak të riskut nga përmbytjet duke ngarkuar organet përgjegjëse për kryerjen e vlerësimit paraprak të riskut nga përmbytjet. Dispozita të tjera të këtij kreu trajtojnë përgatitjen e hartave të riskut nga përmbytjet, hartave të rrezikut nga përmbytjet dhe ngarkojnë organin përgjegjës që në bazë të hartave të përgatisë planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet.

**Kreu XII** trajton përdorimin e burimeve ujore. Në këtë kre përcaktohen qëllimet e përdorimit të burimeve ujore dhe parashikohet përdorimi i lirë i burimeve ujore. Dispozitat e këtij kreu rregullojnë gjithashtu kontrollin administrativ të përdorimit të burimeve ujore, përdorimin e burimeve ujore me leje apo autorizim. Në këtë kre përcaktohen gjithashtu detyrimet e përdoruesve të burimeve ujore.

**Kreu XIII** parashikon rregulla për dhënien e lejeve, autorizimeve për përdorimin e burimeve ujore. Në seksionin 1 përcaktohen parimet e përgjithshme të dhënies së lejeve dhe autorizimeve dhe prioritetet në dhënien e lejeve dhe autorizimeve, organet që lëshojnë lejet dhe autorizimet për përdorimin e burimeve ujore. Dispozitat e këtij seksioni përmbajnë dispozita që trajtojnë kushtet për pezullimin e lejeve dhe autorizimeve, ndryshimin e përkohshëm të kushteve të tyre si dhe rastet e shfuqizimeve. Seksioni 2 trajton kontrollin e shkarkimeve të ujërave industriale.

**Kreu XIV** parashikon rregulla për mbrojtjen e brigjeve, ushtrimin e veprimtarive dhe ndërtimet në brigje, ku pjesë e tij është Seksioni 1 për përcaktimin e veprimtarive ndërtimore në brigje, mbrojtjen e përkohshme, veprimtaritë e ndaluara në brigje dhe plazhe, seksioni 2 për përcaktimin e veprave dhe objekteve ujore dhe kompetencave të organeve të menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore për ndërtimet në trupa ujorë.

**Kreu XV** trajton Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore dhe Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve. Dispozitat e këtij kreu parashikojnë rregulla të krijimit dhe funksionimit të Kadastrës Kombëtare të burimeve ujore dhe Regjistrin Kombëtar të Lejeve dhe Autorizimeve.

**Kreu XVI** përmban parashikimet financiare.

**Kreu XVII**, parashikon kundërvajtjet administrative.

**Kreu XVIII** përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit.

## **VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E KËTIJ PROJEKTAKTI.**

Institucionet e ngarkuara për zbatimin e detyrave që përcaktohen në dispozitat e këtij projektligji janë organet e menaxhimit dhe administrimit të burimeve ujore, njësitë e qeverisjes vendore, strukturat e ministrisë përgjegjëse për mjedisin, shëndetësinë e bujqësinë, energjetikën, infrastrukturën dhe financën, strukturat dhe organet e mbrojtjes civile, rregullimit dhe planifikimit të territorit, inspektoratet që mbulojnë fushën e mjedisit, shëndetësisë dhe bujqësisë, agjencitë mjedisore rajonale.

## **VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT.**

Në kuadër të përafrimit të legjislacionit Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Austriake të Zhvillimit është nënshkruar marrëveshja për projektin “Mbështetja e Bashkimit Evropian për menaxhimin e integruar të ujit në Shqipëri”, e cila është miratuar me VKM-në nr. 587, datë 4.9.2019. Një nga komponentët e këtij projekti është “Përmirësimi i kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”.

Në raportin fillestar u parashikua që projekti do të përgatisë hapat që duhen ndjekur për përmirësimin e legjislacionit shqiptar sipas kërkesave të BE-së. Në zbatim të këtij raporti ekspertët e projektit kanë hartuar dispozitat ligjore

që për afrojnë plotësisht legjislacionin shqiptar me direktivat e BE-së në fushën e ujit si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre (13 akte nënligjore). Numri i neneve të hartuara dhe ndryshimet që ato sjellin në ligjin nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, e tejkalojnë masën e nevojshme për të bërë ndryshime në ligjin aktual, në këto kushte, lindi nevoja e hartimit të ligjit të ri për menaxhimin e ujit në Shqipëri.

Çështjet që kanë lidhje me mbrojtjen e ujit, përdorimin, financimin e këtij sektori janë fushë e përgjegjësisë shtetërore jo vetëm e AMBU-së por dhe të institucioneve të tjera dhe si pasojë kërkohet kontributi i secilit prej tyre.

Theksojmë se dispozitat ligjore të hartuara parashikonin vetëm kërkesat e direktivave të BE-së për mbrojtjen e burimeve ujore ndërsa çështjet e organizimit të brendshëm si kompetencat e institucioneve, sipas fushës së përgjegjësisë, procedura e dhënies së lejeve/autorizimeve marrëdhënieve për ujërat ndërkufitare, inspektimin e zbatimit të ligjit, masat administrative për shkelësit u hartuan nga grupi i punës i ngritur me Urdhrin nr.24 prot., datë 9.02.2021, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e paketës ligjore në fushën e menaxhimit të burimeve ujore”. Grupi Ndërinstitucional i Punës për hartimin e paketës ligjore i kryesuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore kishte në përbërje përfaqësues të institucioneve të mëposhtme:

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ministria e Mbrojtjes

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar

Agjencia Kombëtare e Mjedisit

Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura.

## **IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE.**

Ky ligj duke synuar të për afrojë plotësisht direktivat e BE-së në fushën e ujit parashikon dhe afate për arritjen e këtyre objektivave. Arritja e

objektivave brenda afateve kërkon dhe një parashikim të buxhetit për arritjen e tyre. Gjithashtu, bazuar në Rregulloren e Këshillit të Ministrave, projektligji do të shoqërohet dhe me vlerësimin e shpenzimeve buxhetore dhe efektet financiare të pritshme. Aktualisht me mbështetjen e projektit është në proces hartimi Raporti i Vlerësimit të projektligjit, i cili do të përmbajë edhe parashikimet lidhur me kostot e nevojshme për zbatimin e këtij projektligji.

**KRYEMINISTRI**

**Edi Rama**